



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## KRYETARI I KOMUNËS

### NJOFTIM

Në mbështetje të paragrafit 7.3 të nenit 8 të Ligji Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.464/01-53706 datë 04.10.2022, njoftohen të gjithë subjektet të përshkruar në Vendimin e bashkangjitur të këtij njoftimi se:

1. Për arritjen e qëllimit publik për realizimin e projektit për ndërtimin e parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan, mbas plotësimit të të gjitha kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28.10.2010, me të cilin miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndikohen nga projekti për ndërtimin e parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullaret e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqet e tyre, e cila tabelë është pjesë përbërse e këtij vendimi.
2. Kryetari i Komunës do të marrë një Vendim Preliminar brenda periudhës prej 30-ditëve kalendarike pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28.10.2010, lidhur me organizimin e dëgjimeve publike.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin shpronësues, brenda 10 ditëve kalendarike, mbas shpalljes së Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.464/01-53706 datë 04.10.2022, për miratimin e kërkesës për shpronësim ditën e publikimit në njërin nga gazetatat me tirazh më të madh në Kosovë.
4. Kryetari i Komunës do të mbajë një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e kërkuar për realizimin e projektit për ndërtimin e parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan.
5. Të gjithë personat që janë zyrtar publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi publik apo pronar ose zotruar të interesit në pronën e cila gjindet në këtë pjesë ose avokat apo përfaqësues i ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.

6. Çdo person i interesuar do t'i jepet mundësi e arsyshme për t'i shprehur mendimet e tij/saj gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafët 2,3,4 të nenit 9 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28.10.2010.

7. Çdo person i interesuar i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjell me vete prova të arsyshme (dokumente) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, Pronari ose Zotërues i Interesit.

8. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave tjera në pronat e paluajtshme që ndodhen brenda juridiksionit territorial të komunës së Lipjanit, do të mbahet me **datë 12.10.2022 në ora 10<sup>00</sup>, në objektin Komunës së Lipjanit- salla e Kuvendit.**

9. Në rast se prona është objekt i kërkesës shpronësohet pas përmbylljes së procedurës së shpronësimit të incuar në përputhje me at kërkesë asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmisimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në pronë pas datës së përmbylljes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligji Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/1-205 datë 28 tetor 2010. Çdo person i cili pretendon se ka një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtoj Ligjin Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/1-205 datë 28 Tetor 2010, dhe të kërkojë ndihmë profesionale juridike për kuptimin e drejtave të tyre sipas ligjit.

10. Çdo person i cili nuk është emruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në cilendo parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim menjëherë duhet të dërgojë në Organin shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj, bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikura të çfarëdo dokumenti që ndërlidhen në atë pretendim.

